



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 127

1 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MASH nr. 11, datë 17.5.2013	Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë..... 5381
Vendim i GJK nr. 35, datë 17.7.2013	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm..... 5401
Vendim i GJK nr. 36, datë 25.7.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 90, datë 10.4.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 00-2011-1543, datë 13.10.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)..... 5406

UDHËZIM
Nr. 11, datë 17.5.2013

**PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL TË
PUNONJËSVE ARSIMORË**

Në mbështetje të nenit 102 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 58 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë (drejtor, nëndrejtor, mësues) është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i aftësive të tyre, në mënyrë që t’u sigurojnë të gjithë nxënësve shërbim arsimor më cilësor.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “institucion arsimor” do të thotë kopsht dhe shkollë;
- b) “punonjës arsimor” do të thotë mësues dhe drejtues i institucionit arsimor;
- c) “drejtues” do të thotë drejtor dhe nëndrejtor;
- d) “programi i trajnimit” përbëhet nga një ose disa module trajnimi, të cilat i bashkon një tematikë e përbashkët.

KREU II
IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL
(Për drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve arsimore)

1. Instituti i Zhvillimit Arsimor (IZHA) identifikon kërkesat individuale të punonjësve të institucioneve arsimore sipas kësaj procedure:

- a) punonjësit arsimorë paraqesin nevojat e tyre për zhvillim profesional për një periudhë dyvjeçare me anën e një pyetësoi të përgatitur nga IZHA-ja;
- b) drejtorë të institucioneve arsimore paraqesin nevojat për zhvillim profesional të institucionit të pyetësoi i përgatitur nga IZHA-ja;
- c) drejtorja e institucionit arsimor përmbledh të dhënat e pikave të mësipërme “a” dhe “b”, sipas udhëzuesit të IZHA-së dhe i dërgon në drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA) përkatëse;
- d) DAR/ZA-ja përmbledh, sipas udhëzuesit të IZHA-së, të dhënat e institucioneve arsimore përkatëse dhe i dërgon tek IZHA-ja.

2. IZHA-ja përpunon të dhënat për kërkesat profesionale të drejtuesve dhe të mësuesve për arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, gjimnazin, arsimin profesional dhe arsimin e orientuar, i paraqet te Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe i publikon në faqen e vet të internetit.

3. Një herë në dy vjet, formulonjë rekomandime për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë dhe ia paraqesin Ministrin të Arsimit dhe Shkencës:

- a) Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në MASH, bazuar në politikat e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë;
- b) Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), bazuar në analizat e provimeve kombëtare;
- c) Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), bazuar në gjetjet gjatë inspektimeve;
- d) IZHA-ja dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFP), bazuar në risitë kurrikulare;
- e) çdo DAR/ZA, bazuar në vëzhgimet e saj tek institucionet arsimore;



- f) agjencitë trajnuese, me nismën e tyre.
4. IZHA-ja përgatit çdo dy vjet “Përparësitë e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë”, bazuar në:
- standardet e drejtorit;
 - standarde të përgjithshme të mësuesit;
 - kërkesat e punonjësve të institucioneve arsimore;
 - rekomandimet e përmendura në pikën 3.
5. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton “Përparësitë e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë”, të cilat publikohen në faqen e internetit të IZHA-së.

KREU III AGJENCITË TRAJNUESE (TË PËRGJITHSHME)

A. AGJENCITË TRAJNUESE

- Agjencitë trajnuese mund të jenë publike ose private.
- Trajnimet realizohen nga agjenci trajnuese që janë: institucionet e arsimit të lartë, organizatat joqeveritare, fondacionet dhe subjekte të tjera, që kanë për objekt në statutin e tyre zhvillimin e trajnimeve të punonjësve arsimorë.

B. NUMRI I PJESËMARRËSVE NË TRAJNIM

- Numri i pjesëmarrësve në një seancë trajnimi nuk është më i madh se 25, me përjashtim të rasteve kur metoda e vetme e trajnimit është leksioni.

C. KREDITET

- Tri ditë trajnim përbëhen nga 15 orë trajnim i drejtpërdrejtë me trajnerët.
- Tri ditë trajnim janë të barasvlershme me 2 kredite.

KREU IV KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

A. STATUSI

- Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit, më tutje “KAT”, ngrihet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

- KAT-i akrediton programe trajnimi ose module të tyre, që paraqiten nga agjenci trajnuese.

B. PËRBËRJA, DETYRA TË KRYETARIT DHE SEKRETARIATIT

- KAT-i përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë.
- KAT-i përbëhet nga drejtori i IZHA-së dhe 6 ekspertë. Kryetari i KAT-it është një nga ekspertët dhe zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash në mbledhjen e parë të tij.
- Sektori i kualifikimit të IZHA-së luan rolin e sekretariatit teknik të KAT-it.
- Kryetari i KAT-it:
 - thërret dhe drejton mbledhjet e KAT-it;
 - i paraqet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës raportin vjetor të veprimtarisë së KAT-it;
 - detyra të tjera të kryetarit përshkruhen më poshtë në këtë udhëzim.
- Sekretariati i KAT-it:
 - njofton anëtarët e KAT-it për mbledhjet e tij;
 - mban procesverbalin e mbledhjeve të KAT-it, ku shënohet edhe pjesëmarrja e anëtarëve, dhe ua shpërndan të gjithë anëtarëve të tij;
 - përditëson databazen e të dhënave për modulet e akredituara, e cila përmban: emrin e agjencisë trajnuese, numrin dhe datën e vendimit të akreditimit, numrin e certifikatës së akreditimit, datën e lëshimit të saj, temën e modulit, kodin dhe numrin përkatës të krediteve;
 - mban regjistrin e korrespondencës për KAT-in;

e) ruan në arkivin e KAT-it, për tre vjet nga data e hartimit të tyre, procesverbalet e mbledhjeve të KAT-it, aplikimet e agjencive trajnuese, vlerësimet e aplikimeve, kopjet e certifikatave të akreditimit dhe masat ndaj agjencive trajnuese;

f) detyra të tjera të sekretariatit përshkruhen më poshtë në këtë udhëzim.

6. Ministri i Arsimit dhe Shkencës e zëvendëson kryetarin dhe anëtarin e KAT-it kur:

a) gjatë dy viteve kalendarike mungon në më shumë se 30% të mbledhjeve të KAT-it;

b) ka prova të shkeljeve në kryerjen e detyrës ose të respektimit të deklaratës sipas modelit të shtojcës 1.

C. VENDIMET E KAT-it

1. KAT-i i merr vendimet me shumicë votash, kurse kur votat janë të barabarta vendimi merret sipas votës së kryetarit të tij.

2. Mbledhjet e KAT-it për marrjen e vendimeve zhvillohen me pjesëmarrjen e të paktën 2/3-ve të anëtarëve të tij, përfshirë kryetarin.

3. Sekretarët e KAT-it nuk kanë të drejtë vote.

4. Vendimet e KAT-it nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët e tij.

KREU V

SHPALLJA E INTERESIT PËR TRAJNIME DHE APLIKIMI I AGJENCIVE TRAJNUESE

A. SHPALLJA E INTERESIT PËR TRAJNIME

1. IZHA-ja, bazuar në “Përparësitë e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë”, harton për çdo vit kalendarik, “Fushat përparësore të trajnimit dhe tematikat përparësore për çdo fushë” dhe ia paraqet për miratim Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

2. Numri i tematikave për çdo fushë është i kufizuar dhe në përputhje me përparësitë e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë për një periudhë dyvjeçare.

3. Shpallja e interesit për trajnime publikohet në muajin qershor në faqen e internetit të MASH-it dhe të IZHA-së dhe përmban “Fushat përparësore të trajnimit dhe tematikat përparësore për çdo fushë”.

4. Me porosi të Ministrisë, IZHA-ja shpall interesin për tematika të tjera trajnimi në çdo periudhë të vitit kalendarik.

B. APLIKIMI I AGJENCIVE TRAJNUESE

1. Një agjenci trajnuese, bazuar në “Fushat përparësore të trajnimit dhe tematikat përparësore për çdo fushë”, aplikon te sekretaria e KAT-it për të fituar të drejtën e trajnimit për module të caktuara.

2. Periudha e aplikimit për një vit kalendarik është 1 tetor - 30 tetor.

3. Dokumentacioni i aplikimit përmban këto të dhëna:

a) emri i agjencisë trajnuese;

b) të dhënat e kontaktit;

c) një kopje e noterizuar e dokumenteve të legjitimitetit të agjencisë;

d) aplikimi për modulën, sipas modelit të shtojcës 2;

e) CV e trajnerëve për modulën, sipas modelit të shtojcës 3.

C. TRAJNERËT

Kanë të drejtë të jenë trajnerë për një modul:

a) Pedagogët e shkollave të larta të programeve të studimit të mësuesisë që kanë të paktën titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”, për module të specialitetit të tyre kur kanë të paktën 5 vjet përvojë në mësuesinë.

b) Specialistë në fushën e trajnimit, që kanë të paktën titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”, sipas profileve përkatëse me një përvojë të paktën 5-vjeçare në fushën e trajnimit.



KREU VI VLERËSIMI I MODULEVE

A. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT

1. Periudha e shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit të agjencive trajnuese është 1 nëntor - 30 nëntor.
2. Sekretariati shqyrton dokumentacionin e aplikimit dhe i raporton me shkrim KAT-it për dy aspekte:
 - a) përputhja e statusit të agjencisë me tematikën e trajnimit për të cilën aplikon;
 - b) plotësia e dokumentacionit të aplikimit sipas modelit të shtojcës 4.
3. KAT-i, bazuar në raportin e sekretariatit, vendos:
 - a) të mos pranojë aplikimin e agjencisë që nuk e ka në statusin e saj tematikën e trajnimit për të cilën aplikon;
 - b) të kthejë për plotësim, kur ka mungesa në dokumentacion, brenda 5 ditëve nga njoftimi për plotësim.
4. Agjencia trajnuese nuk ka të drejtë që, gjatë plotësimit të dokumentacionit sipas pikës 3/b, të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj.
5. Një agjencie trajnuese i jepet vetëm një herë mundësia për të plotësuar dokumentacionin e aplikimit. Kur dokumentacioni nuk plotësohet brenda afatit të përcaktuar, KAT-i nuk e pranon aplikimin.

B. GRUPET E VLERËSIMIT TË MODULEVE

1. Një modul vlerësohet nga një grup prej dy anëtarësh.
2. Anëtar i grupit të vlerësimit të një moduli, më tutje “grupi”, është mësues ose specialist që zotëron njohuri të mjaftueshme për modulin, të dëshmuara në CV-të e tyre.

Mësuesi, që i është nënshtruar provimit të kualifikimit, është anëtar i grupit kur është vlerësuar me “shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”.
- Drejtuesi, institucioni i të cilit është inspektuar, pranohet për vlerësues, nëse institucioni është vlerësuar me të paktën “mirë”.
3. Aplikuesi për vlerësues dorëzon CV-në tek IZHA-ja, sipas modelit të shtojcës 3.
4. IZHA-ja:
 - a) shpall kërkesën për vlerësues në fillim të çdo viti kalendarik;
 - b) harton listën e kandidatëve për vlerësues përmes konkurrimit nëpërmjet CV-ve të tyre.
5. KAT-i vendos:
 - a) për listën e vlerësuesve;
 - b) përbërjen e grupeve të vlerësimit për çdo modul;
 - c) të largojë vlerësues për shkak të shkeljeve në detyrën e tij ose të deklaratës.
6. Sekretarët zhvillojnë seanca informuese me vlerësuesit për mirëkryerjen e detyrës së tyre.

C. VLERËSIMI I MODULEVE

1. Formatet e aplikimit nuk përmbajnë ndonjë shenjë dalluese të agjencisë, por vetëm një kod të vendosur nga sekretariati. Formatet, që përmbajnë shenjë dalluese përjashtohen nga konkurrimi.
2. Sekretariati organizon veprimtarinë e grupeve të vlerësimit.
3. Anëtari i një grupi shqyrton më parë përmbajtjen e të gjitha moduleve me temë të njëjtë që janë paraqitur për vlerësim nga agjenci të ndryshme.
4. Grupi plotëson formatin e vlerësimit për çdo modul, sipas modelit të shtojcës 5, dhe e dorëzon te sekretariati i KAT-it.
5. Sekretariati nuk ka të drejtë t'i kërkojë grupit të ndryshojë vlerësimet dhe as t'i ndryshojë vetë ato.

KREU VII AKREDITIMI I PROGRAMEVE/MODULEVE TË TRAJNIMIT

A. PROCEDURA E AKREDITIMIT

1. KAT-i:

a) shqyrton formatet e plotësuara nga grupet e vlerësimit, më tutje “grup”, që i dorëzon sekretariati;

b) vendos t’u kthejë për plotësim ose saktësim grupeve vlerësimit e tyre.

2. KAT-i mund të thërrasë grupin për t’u sqaruar për vlerësimin e kryer prej tij.

3. KAT-i nuk ka të drejtë t’i kërkojë grupit të ndryshojë vlerësimet dhe as t’i ndryshojë vetë ato.

4. KAT-i vendos:

a) cilat module do të akreditohen;

b) numrin e krediteve të çdo moduli të agjencive fituese;

c) në raste të veçanta, KAT-i konsultohet për numrin e krediteve me specialistë të modulit.

5. Për një tematikë nga “Fushat përparësore të trajnimit dhe tematikat përparësore për çdo fushë” mund të akreditohen disa agjenci aplikuese.

6. Sekretariati përgatit vendimet e akreditimit dhe certifikatat e akreditimit.

7. Kryetari i KAT-it paraqet certifikatat e akreditimit, për firmë dhe vulë, te personi i autorizuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

8. Sekretariati njofton agjencitë trajnuese për vendimet e KAT-it brenda 10 ditëve nga marrja e vendimeve. Në vendim përfshihet dhe vlerësimi i modulit nga grupi i vlerësimit.

9. Certifikata e akreditimit për një program/modul trajnimi është e vlefshme për tre vjet nga data e nënshkrimit të saj.

10. Pas skadimit të vlefshmërisë së certifikatës, agjencia mund të aplikojë për përtëritjen e saj sipas procedurave të aplikimit të përshkruara në këtë udhëzim.

B. ANKIMI

Agjencia trajnuese ka të drejtën e ankimit me shkrim te Ministri i Arsimit dhe Shkencës brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e KAT-it dhe ka të drejtë të marrë përgjigje brenda 30 ditëve nga dorëzimi i ankesës.

KREU VIII KATALOGU I TRAJNIMEVE

1. IZHA-ja publikon formatin e katalogut në faqet e saj të internetit.

2. Agjencia trajnuese dërgon me postë elektronike te sekretariati i KAT-it, sipas formatit të katalogut, të dhënat e mëposhtme për modulën e akredituar.

Pjesa e parë përmban të dhënat për modulën që agjencia do të trajnojë:

a) emri i agjencisë;

b) të dhënat e kontaktit (adresa e e-mail-it, numri i celularit, linku i faqes së internetit të agjencisë, nëse ka);

c) mjedisi (mjediset) ku agjencia ofron trajnimin e modulit, të përshkruara me saktësi;

d) datat dhe orët përkatëse që agjencia ofron trajnimin;

e) të dhënat për modulën sipas shtojcës 2.

Pjesa e dytë përmban numrin e punonjësve arsimorë të certifikuar nga kjo agjenci për këtë modul. (Për drejtuesit, sipas niveleve arsimore; për mësuesit, sipas niveleve arsimore dhe, po të jetë nevoja, sipas lëndëve.)

3. IZHA-ja publikon katalogun në faqen e vet të internetit.



KREU IX PLOTËSIMI I KËRKESAVE PËR TRAJNIME

1. Kur trajnimi është në periudhën e punës mësuesi paraqet kërkesën për trajnim te drejtori i institucionit arsimor, e cila miratohet nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse.
2. Punonjësi arsimor përzgjedh nga Katalogu agjencinë trajnuese, modulet sipas profilit të tij, të rekomanduara nga ekipi kurrikular përkatës dhe këshilli i mësuesve të shkollës.
3. Njësitë arsimore vendore organizojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, në bashkëpunim me agjenci trajnuese, me programe trajnimi të akredituara.
4. Punonjësit e njësisë arsimore vendore, përfshirë titullarin, e kanë të ndaluar të ndikojnë tek institucionet arsimore në përzgjedhjen e agjencive trajnuese.

KREU X PROVIMET E AGJENCIVE TRAJNUESE

A. PJESËMARRJA NË PROVIM

1. Për të fituar kreditet e një moduli, punonjësi arsimor i nënshtrohet provimit për atë modul.
2. Agjencia organizon provimin në përfundim të zhvillimit të një moduli.
3. Agjencia trajnuese zhvillon provimet me punonjësit arsimorë të trajnuar prej saj.
4. Punonjësi arsimor, që do të japë provim, dorëzon tek agjencia portofolin e tij të modulit, pas përfundimit të modulit, i cili përmban detyrat që i trajnuari duhet të zhvillojë për modulin siç përshkruhet te shtojca 4.
5. Agjencia trajnuese vendos nëse do t'i nënshtrohet ose jo provimit një pjesëmarrës në trajnim bazuar në:
 - a) ndjekjen e të gjitha orëve trajnuese;
 - b) përmbajtjen e portofolit të tij.
6. Agjencia trajnuese njofton ISHA-në dhe DAR-in ose ZA-në, me postë elektronike, 15 ditë para datës së provimit për vendin dhe orën e saktë të provimit. ISHA-ja, DAR ose ZA dërgojnë vëzhgues për disa nga provimet që zhvillohen dhe njoftojnë KAT-in kur provimi nuk zhvillohet.
7. Testi për një modul vlerëson sa të trajnuarit përmbushin rezultatet e pritshme të modulit.
8. Pjesëmarrësit në provim vlerësohen për prezantimin e një teme para grupit dhe për një provim me shkrim.
9. Agjencia trajnuese njofton secilin pjesëmarrës për përfundimet në provim.
10. Pjesëmarrësi në provim ka të drejtë të ankohet me shkrim ose postë elektronike te drejtuesi i agjencisë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i përfundimeve dhe të marrë përgjigje me shkrim prej tij brenda 10 ditëve nga dorëzimi i ankesës. Përfundimi i testit mund të ndryshohet kur e vendos komisioni i ngritur nga drejtuesi i agjencisë. Fletëtestet me përgjigjet e të trajnuarve ruhen nga agjencia për një vit nga data e zhvillimit të provimit dhe janë objekt i inspektimit.
11. Pjesëmarrësi në trajnim e depoziton një kopje të temës së prezantuar në arkivin e institucionit arsimor.

B. CERTIFIKATA PËR PUNONJËSIN ARSIMOR

1. Certifikata e një moduli i jepet punonjësit arsimor kur në provim ka grumbulluar të paktën 50% të pikëve.
2. Në certifikatë shënohen: emërtimi i modulit dhe numri përkatës i krediteve.
3. Certifikatat përgatiten nga agjencia trajnuese, firmosen nga drejtuesi i agjencisë dhe kanë vulën e agjencisë.
4. Mësuesi, i certifikuar për një modul, njofton drejtorin e institucionit dhe titullarin e njësisë përkatëse arsimore vendore për temën e modulit.
5. Drejtori i institucionit, i certifikuar për një modul, njofton titullarin e njësisë përkatëse arsimore vendore për temën e modulit.

6. Drejtoria e institucionit arsimor dhe njësia arsimore vendore mbajnë databazen e mësuesve dhe drejtorëve të certifikuar.

KREU XI VËZHGIMI DHE VLERËSIMI I VEPRIMTARISË SË AGJENCIVE TRAJNUESE TË AKREDITUARA

1. Vëzhgimi dhe vlerësimi i seancave trajnuese kryhet pa paralajmërim nga ISHA-ja, sipas modelit të shtojcës 6.
2. Tabelat e plotësuara të vëzhgimit dhe të vlerësimit:
 - a) i dorëzohen agjencive përkatëse trajnuese;
 - b) dërgohen me postë elektronike te sekretaria e KAT-it.
3. Sekretaria përmbledh vlerësimet vjetore dhe ia paraqet KAT-it.

DEKLARATA

Para fillimit të detyrës, kryetari, anëtarët e KAT-it, sekretarët, anëtarët e grupeve të vlerësimit të moduleve dhe të ekipeve të vëzhgimit e të vlerësimit nënshkruajnë deklaratën për qëndrimin e tyre etik gjatë kryerjes së detyrës.

KREU XII PROPOZIME PËR MASA

1. ISHA-ja i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës të marrë masa kundrejt agjencisë trajnuese kur agjencia:
 - a) kryen shkelje të këtij udhëzimi;
 - b) falsifikon të dhënat në dokumentacionin e aplikimit dhe ato në faqen e saj në internet;
2. Sipas shkallës së shkeljes, propozimi për masë është:
 - a) paralajmërim i pezullimit të veprimtarisë së agjencisë trajnuese;
 - b) agjencia paralajmërohet vetëm një herë gjatë një periudhe 4-vjeçare;
 - c) pezullimi i veprimtarisë së agjencisë për një modul për 1-3 vjet;
 - d) heqja e së drejtës së trajnimit për një modul të caktuar;
 - e) ndalimi i agjencinë trajnuese për 1-3 vjet për të aplikuar.
3. Sekretariati përditëson tabelën e masave ndaj agjencive trajnuese.

KREU XIII RRJETET PROFESIONALE QËLLIMI

Rrjeti profesional është formë e zhvillimit profesional të punonjësve të institucioneve arsimore, që synon shkëmbimin e përvojave dhe mendimeve të anëtarëve të tij për praktikën e punës së tyre të përditshme.

KREU XIV PJESËMARRJA NË RRJET

1. Në një rrjet profesional, më tutje “rrjet”, bëjnë pjesë jo më shumë se 25 punonjës arsimorë si më poshtë:
 - a) drejtues të shkollave;
 - b) mësues të fillores;
 - c) mësues të një lënde në një nivel arsimor;
 - d) mësues të së njëjtës fushë të nxëni në një nivel arsimor.



2. Anëtarët e rrjetit, që e kanë të mundur, formojnë gjithashtu, rrjetin *on-line*, nëpërmjet të cilit midis dy takimeve të rrjetit vazhdojnë të shkëmbejnë përvoja, të parashtrojnë pyetje dhe të marrin përgjigje nga kolegët.

KREU XV TAKIMET

1. Në çdo takim të rrjetit shtjellohet një temë e paracaktuar për praktikën e punës së përditshme, që planifikohet nga drejtuesi i rrjetit në bashkëpunim me anëtarët e tij.

2. Rrjeti zhvillon takime çdo dy muaj.

3. Takimet e një rrjeti zhvillohen në mjediset e një institucioni arsimor.

4. Një takim i një rrjeti profesional zgjat afërsisht 90 minuta.

KREU XVI DAR/ZA

1. DAR/ZA përfshin në rrjet punonjësit arsimorë të institucioneve arsimore nën juridiksion.

2. DAR/ZA:

a) organizon rrjetet;

b) vëzhgon zhvillimin e takimeve dhe vlerëson cilësinë e tyre.

3. Titullari i DAR/ZA-së cakton specialistët e DAR/ZA-së për të organizuar, vëzhguar dhe vlerësuar rrjete të caktuara.

4. Specialisti i DAR/ZA-së harton raportin e vlerësimit për rrjetin e vëzhguar, sipas modelit në shtojcën 7 dhe i dorëzon nga një kopje drejtuesit të rrjetit dhe përgjegjësit të sektorit të kurrikulës.

5. Specialistët, që mbulojnë veprimtarinë e rrjeteve, organizojnë, një herë në tre muaj, takime me drejtuesit e tyre për të shkëmbyer mendime për përmirësimin e cilësisë së rrjeteve.

6. Çdo specialist i paraqet përgjegjësit e sektorit të kurrikulës listën e pjesëmarrjes në rrjetet që mbulon.

7. Përgjegjësi i sektorit të kurrikulës përditëson tabelën e pjesëmarrjes në rrjete të punonjësve të institucioneve arsimore dhe i dërgon drejtorit të çdo institucioni arsimor pjesëmarrjen në rrjet të punonjësve arsimor të institucionit.

KREU XVII DREJTUESI I RRJETIT

1. Drejtuesi i rrjetit:

a) Ka përgjegjësi për zhvillimin cilësor të takimeve të rrjetit nëpërmjet organizmit të përgatitjes paraprake të anëtarëve të rrjetit dhe moderimit të takimit.

b) Moderon takimet e rrjetit.

c) Plotëson tabelën e pjesëmarrjes me firmën e çdo pjesëmarrësi dhe e dorëzon te specialisti përkatës i DAR/ZA-së.

2. Drejtuesi i një rrjeti të mësuesve duhet:

a) të ketë punuar të paktën 10 vjet si mësues (parapëlqehen mësues me merita profesionale, që kanë kaluar të tria shkallët e kualifikimit);

b) të jetë vlerësuar me “shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm” në provimet e kualifikimit, nëse ka marrë pjesë në to;

c) të jetë vlerësuar me “shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm” në modulet e trajnimit, nëse ka marrë pjesë në to.

3. Drejtuesi i një rrjeti të drejtuesve të institucioneve arsimore duhet:

a) të ketë punuar të paktën 5 vjet si drejtor i një institucioni arsimor;

b) t'i përkasë një shkollë që zë një vend të shquar në renditjen e shkollave sipas treguesve të shkollave të suksesshme;

- c) të jetë vlerësuar institucioni arsimor me të paktën “mirë” nga ISHA-ja, nëse është inspektuar.
4. Drejtuesi i rrjetit zëvendësohet me kërkesën e anëtarëve të rrjetit ose nga specialisti që mbulon atë rrjet në DAR/ZA.

KREU XVIII

SEANCAT INFORMUESE TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË QENDRORE TË MASH-IT

1. IZHA, AKAFPK, AKP dhe ISHA zhvillojnë me specialistë të DAR/ZA-ve seanca informuese për risi të reformave arsimore dhe udhëzimet e reja të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
2. Tematika dhe përmbajtja e seancave informuese miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
3. Drejtorët e institucioneve të sipërpërmendura njoftojnë KAT-in për tematikat e seancave informuese.

KREU XIX

DAR/ZA

1. DAR/ZA-të organizojnë seanca informuese me punonjësit përkatës arsimorë si vazhdim i seancave informuese të zhvilluara nga njësitë e varësisë qendrore.
2. IZHA-ja publikon në faqen e saj të internetit tematikat e seancave informuese dhe përmbajtjen e këtyre seancave.

ASPEKTE TË TJERA TË ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL

KREU XX

KËSHILLIMET

1. DAR/ZA-të planifikojnë dhe organizojnë këshillimin e punonjësve arsimorë për:
 - a) çështje të praktikës së përditshme të menaxhimit të institucionit arsimor dhe mësimdhënies e nxënies;
 - b) zbatime të udhëzimeve të reja të MASH-it ose udhëzuesve të njërive të varësisë së saj qendrore.
2. Këshillimi realizohet:
 - a) sipas një kalendarit, në mjediset e DAR/ZA-së, nga specialistë të DAR/ZA-së ose punonjës arsimorë të përzgjedhur prej tyre;
 - b) me postën elektronike;
 - c) nëpërmjet letrave qarkulluese që u dërgohen institucioneve arsimore.

KREU XXI

PËRHAPJA E PRAKTIKAVE TË SUKSESSHME

1. ISHA-ja grumbullon, gjatë inspektimeve, praktikat e suksesshme të institucioneve dhe të punonjësve të veçantë arsimorë, i publikon herë pas here dhe një herë në vit në faqen e vet të internetit.
2. DAR/ZA-të, gjatë vëzhgimeve në institucionet arsimore, grumbullojnë praktika të suksesshme të institucioneve dhe të punonjësve të veçantë arsimorë, i qarkullojnë nëpërmjet letrave të tyre dhe i publikojnë herë pas here në faqen e tyre të internetit.
3. IZHA-ja:
 - a) publikon në faqen zyrtare materiale në ndihmë të mësuesve dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore;
 - b) gjatë komunikimeve me punonjës arsimorë, grumbullon praktika të tyre të suksesshme, i baton herë pas here dhe një herë në vit i publikon në faqen e vet të internetit;
 - c) përdor faqen zyrtare për shkëmbime mendimesh dhe përvojash në mes punonjësve arsimorë.



Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Planifikimit Buxhetor, IZHA, ISHA dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

SHTOJCA 1
DEKLARATË

Unë i nënshkruari/e nënshkruara _____ me cilësinë e _____, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe të udhëzimit të Ministrit “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, deklaroj si më poshtë vijon:

- a) Nuk punoj me kohë të plotë ose të pjesshme në ndonjë agjenci trajnuese që aplikon pranë KAT-it.
- b) Nuk kam pjesëtarë të familjes dhe as të afërm (prind, bashkëshort, fëmijë, vëlla, motër) të cilët punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme në agjencinë trajnuese që aplikon pranë KAT-it.
- c) Nuk aktivizohem në asnjë shërbim trajnues për të cilin agjencitë aplikojnë.
- d) Nuk kam pjesëtarë të familjes e as të afërm (prind, bashkëshort, fëmijë, vëlla, motër), të cilët aktivizohen në shërbimin trajnues për të cilin agjencitë aplikojnë.
- e) Nuk do të ndikohem nga arsye personale për vlerësim të pamerituar të ndonjë moduli.
- f) Nuk do të ndikohem nga persona të tjerë për vlerësim të pamerituar të ndonjë moduli.
- g) Nuk do të ndikoj te të tjerët për vlerësim të pamerituar të ndonjë moduli.
- h) Nuk do të pranoj çfarëdo lloj përfitimi vetjak ose për të afërmit e mi me qëllim vlerësimin e pamerituar të ndonjë moduli.
- i) Do të denoncoj çfarëdo lloj ndërhyrjeje që bëhet nga kolegë apo persona të tjerë për vlerësim të pamerituar të ndonjë moduli.
- j) Nuk do të nxjerr informacione rreth vlerësimit të një moduli, që nuk është shpallur ende zyrtarisht.
- k) Nuk do të deklarohem në media për vendimet pa qenë i autorizuar.
- l) Nuk do të paraqes pikëpamjet e mia vetjake si qëndrime të institucionit ku bëj pjesë.

Për sa më sipër, mbaj përgjegjësi të plotë për këto deklarime:

Data e dorëzimit të deklaratës: _____

Emri, mbiemri _____

Nënshkrimi: _____

Shënim.

Deklarata e mësipërme nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e KAT-it, si dhe anëtarët e grupeve të vlerësimit.

DEKLARATË

Unë i nënshkruari/e nënshkruara _____ me cilësinë e _____, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, udhëzimit “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, deklaroj si më poshtë vijon:

- a) Nuk punoj me kohë të plotë ose të pjesshme në ndonjë agjenci trajnuese që aplikon pranë KAT-it.
- b) Nuk kam pjesëtarë të familjes dhe as të afërm (prind, bashkëshort, fëmijë, vëlla, motër) të cilët punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme në agjencinë trajnuese që aplikon pranë KAT-it.
- c) Nuk aktivizohem në asnjë shërbim trajnues për të cilin agjencitë aplikojnë.
- d) Nuk kam pjesëtarë të familjes e as të afërm (prind, bashkëshort, fëmijë, vëlla, motër), të cilët aktivizohen në shërbimin trajnues për të cilin agjencitë aplikojnë.
- e) Nuk do të ndikoj te të tjerët për vlerësim të pamerituar të ndonjë moduli.
- f) Do të denoncoj çfarëdo lloj ndërhyrjeje që bëhet nga kolegë apo persona të tjerë për vlerësim të pamerituar të ndonjë moduli.
- g) Nuk do të nxjerr informacione rreth vlerësimit të një moduli, që nuk është shpallur ende zyrtarisht.
- h) Nuk do të deklarohej në media për vendimet pa qenë i autorizuar.
- i) Nuk do të paraqes pikëpamjet e mia vetjake si qëndrime të institucionit ku bëj pjesë

Për sa më sipër, mbaj përgjegjësi të plotë për këto deklarime:

Data e dorëzimit të deklaratës: _____

Emri, mbiemri _____

Nënshkrimi: _____

Shënim.

Deklarata e mësipërme nënshkruhet nga sekretarët e KAT-it.



DEKLARATË

Unë i nënshkruari/e nënshkruara _____ me cilësinë e _____, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe të udhëzimit të Ministrisë “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, deklaroj si më poshtë vijon:

- a) Nuk punoj me kohë të plotë ose të pjesshme në ndonjë agjenci trajnuese që aplikon pranë KAT-it.
- b) Nuk kam pjesëtarë të familjes dhe as të afërm (prind, bashkëshort, fëmijë, vëlla, motër) të cilët punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme në agjencinë trajnuese që aplikon pranë KAT-it.
- c) Nuk aktivizohem në asnjë shërbim trajnues për të cilin agjencitë aplikojnë.
- d) Nuk kam pjesëtarë të familjes e as të afërm (prind, bashkëshort, fëmijë, vëlla, motër), të cilët aktivizohen në shërbimin trajnues për të cilin agjencitë aplikojnë.
- e) Nuk do të ndikohem nga arsye personale për monitorim dhe vlerësim të pamerituar të trajnimit të një moduli nga çdo agjenci trajnuese.
- f) Nuk do të ndikohem nga persona të tjerë për monitorim dhe vlerësim të pamerituar të trajnimit të një moduli nga çdo agjenci trajnuese.
- g) Nuk do të ndikoj të tjerët për monitorim dhe vlerësim të pamerituar të trajnimit të një moduli nga çdo agjenci trajnuese.
- h) Nuk do të pranoj çfarëdo lloj përfitimi vetjak ose për të afërmit e mi me qëllim për monitorim dhe vlerësim të pamerituar të trajnimit të një moduli nga çdo agjenci trajnuese.
- i) Do të denoncoj çfarëdo lloj ndërhyrjeje që bëhet nga kolegë apo persona të tjerë për vlerësim të pamerituar të trajnimit të një moduli nga çdo agjenci trajnuese.
- j) Nuk do të nxjerr informacione rreth vlerësimit të një moduli, që nuk është shpallur ende zyrtarisht.
- k) Nuk do të deklarohej në media për vendimet pa qenë i autorizuar.
- l) Nuk do të paraqes pikëpamjet e mia vetjake si qëndrime të institucionit ku bëj pjesë.

Për sa më sipër, mbaj përgjegjësi të plotë për këto deklaratime:

Data e dorëzimit të deklaratës: _____

Emri, mbiemri _____

Nënshkrimi: _____

Shënim.

Deklarata e mësipërme nënshkruhet nga vlerësuesit e moduleve të trajnimit.

SHTOJCA 2
FORMATI I APLIKIMIT PËR NJË MODUL

1. Tema e modulit
2. Numri i orëve të trajnimit
3. Numri i seancave dhe tema e çdo seance
4. Përfituesit nga trajnimi
5. Rezultatet e pritshme
6. Përshkrimi i përmbajtjes
7. Metodologjia:
 - a) metodat gjatë trajnimit;
 - b) mjetet mësimore;
 - c) detyra për të trajnuarit;
 - d) literatura e rekomanduar për të trajnuarit.
8. Testet
9. Bibliografia

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FORMATIT TË APLIKIMIT

1. Tema e modulit
2. Numri i orëve të trajnimit
3. Numri i seancave dhe tema e çdo seance
4. Përfituesit nga trajnimi
Përfituesit e mundshëm nga trajnimi janë:
Drejtor i institucionit arsimor
Tregoni nivelin arsimor ku punon (parashkollor, fillor, arsimit të mesëm i ulët, arsimit të mesëm i lartë.
Kur është drejtor i arsimit të mesëm të lartë, specifikoni a është gjimnaz, arsim profesional apo shkollë e mesme e orientuar.
Mësues
Përcaktoni nivelin arsimor ku punon. Për arsimin e mesëm, tregoni lëndën.
Kur për arsimin fillor, tematika e trajnimit ka të bëjë me një fushë të nxëni, tregojeni atë.
5. Rezultatet e pritshme
Përshkruani se çfarë duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të bëjnë të trajnuarit në përfundim të modulit.
Çdo rezultat duhet të jetë i matshëm.
Një rezultat paraqitet me një frazë.
6. Përshkrimi i përmbajtjes
Përmbajtja e modulit përshkruhet përmbledhtas. Përshkrimi përmban konceptet kryesore që do të trajtohen, pa përfshirë metodologjinë.
Ju do t'i përgjigjeni pyetjes “Çfarë trajneri do të zhvillojë gjatë një moduli?”
Përshkrimi të jetë 1/3 deri në 1/2 e një faqe A4, e shkruar në kompjuter me Times New Roman.
7. Metodologjia
 1. Te metodologjia përshkruhet përmbledhtas si trajneri do ta zhvillojë përmbajtjen dhe si pjesëmarrësit në trajnim do të arrijnë rezultatet e pritshme. Metodologjia përmban këto elemente:
 - a) Përshkrimi i konkretizuar i **metodave gjatë trajnimit**, si: leksioni, demonstrimi, debati, diskutimi, eksperimentimi, puna e pavarur individuale, puna në grupe të vogla, puna me të gjithë klasën, puna me anën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, loja me role, vizita studimore, biseda me të ftuar etj.
 - b) Përshkrimi i konkretizuar i **mjeteve mësimore**.



- Vizuale (fotografi, piktura, diafilma, diapozitivë, flipçart, grafikë, diagrame etj.)
 - Auditivë (magnetofoni, kasetofoni, radioja etj.)
 - Audovizuale (filmi, televizioni, videoja etj.)
2. Detyra për të trajnuarit, për t'i kryer gjatë ose/dhe pas modulit, janë punë individuale ose në grup për përgatitje të detyrave tematike, rasteve studimore, projekteve, eseve etj. Këto detyra zënë pjesën më të madhe të punës së të trajnuarit, rreth 4-fishin e kohës për seanca trajnuese.
- c) Literatura e rekomanduar për të trajnuarit për t'u shfrytëzuar gjatë dhe pas modulit. Literatura përmban jo vetëm titujt e librave ose të shkrimeve por, edhe ekstrakte të tyre dhe, numrin e faqeve dhe cilat faqe duhet të studjohet i trajnuari.

Metodologjia të jetë 1 (një) deri në 1,5 faqe A4 e shkruar në kompjuter me Times New Roman.

3. Testet

Dy teste për provimin e modulit bashkë me përgjigjet e tyre.

Një test parashikohet të zhvillohet nga i trajnuari për rreth 60 – 90 minuta dhe synon të verifikojë përmbushjen e rezultateve të të nxënit. Në çdo test shënohet dhe kohëzgjatja e tij.

4. Bibliografia kryesore e përdorur për të hartuar modulin.

Vendosni një numër të kufizuar botimesh (libra, shkrime ose nga interneti)

SHTOJCA 3 CURRICULUM VITAE (për trajnerë ose vlerësues të moduleve)

MBIEMRI
EMRI
DATËLINDJA

TEL.
ADRESA E-MAIL

ARSIMI
TITULL OSE GRADË SHKENCORE
PUNËSIMI
CERTIFIKATA
PRODUKTE PROFESIONALE

Emri, mbiemri

Firma

Data

.....

UDHËZIME
PLOTËSIMI I CURRICULUM VITAE

ARSIMI

Diploma (diplomat) e institucioneve të shkollës së lartë

PUNËSIMI

Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet, duke filluar nga e tanishmja e deri te punësimi i parë.

Për çdo punësim shkruhen:

- Viti i fillimit dhe i mbarimit të tij,
- Titulli i vendit të punës (specialist, përgjegjës i sektorit të ..., drejtor i drejtorisë së)

P.sh.

2007-2011 Pedagog në universitetin, dega

2004-2006 Mësues i historisë, gjimnaz

2000-2004 Mësues i historisë, arsimit bazë

CERTIFIKATA

1. Shënohen vetëm certifikatat që kanë lidhje me modulin (modulet).

Për trajnerin, bashkëngjiten kopjet e certifikatave.

Renditen certifikatat, e marra brenda ose jashtë vendit, bashkë me vendin dhe vitin e marrjes së certifikatës.

Fillohet me certifikatën më të fundit dhe përfundohet me atë më të hershmen.

2. Kualifikimi (nëse trajneri ose vlerësuesi kanë marrë pjesë në provimet e kualifikimit)

Për trajnerin, bashkëngjiten kopjet e dëshmive të kualifikimit.

3. Vlerësimi i institucionit nga inspektorati (nëse institucioni është vlerësuar)

Për trajnerin, bashkëngjiten kopjet e vlerësimit zyrtar të institucionit.

PRODUKTE PROFESIONALE

Shënohen vetëm produktet profesionale që kanë lidhje me modulin (modulet).

Produkte profesionale janë:

- Libra ose shkrime të botuara;
- Kumtesa të mbajtura në organizime ndërkombëtare ose kombëtare.

Për çdo produkt profesional shkruhet:

- Emri mbiemri i bashkautorëve,
- Titulli,
- Institucioni botues ose organizues,
- Viti.



SHTOJCA 4
PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT

Emri i agjencisë _____

Tema e modulit _____

1. Emri i agjencisë trajnuese
2. Kopje e dokumenteve të legjitimitetit
3. Të dhënat e kontaktit Adresa e <i>e-mail</i> -it Numri i celularit Linku i agjencisë (nëse ka)
4. Numri i orëve të trajnimit
5. Tema e modulit
6. Numri i seancave
7. Temat e seancave
8. Përfituesit nga trajnimi
9. Rezultatet e pritshme
10. Përshkrimi i përmbajtjes
11. Metodat gjatë trajnimit
12. Mjetet mësimore
13. Detyrat
14. Literatura e rekomanduar
15. Testet
16. Bibliografia
17. CV e trajnerëve
18. Kopjet e certifikatave Kopjet e dëshmive të kualifikimit (nëse ka) Kopjet e vlerësimit zyrtar të institucionit (nëse ka)

Emri mbiemri _____

Firma _____

Data _____

UDHËZIMI PËR PLOTËSIMIN E TABELËS

Sekretari vendos shenjën X” në shtyllën e dytë, aty ku konstaton mungesën e dokumentacionit përkatës.

**SHTOJCA 5
FORMATI I VLERËSIMIT**

Tema e modulit _____
Përfituesit _____

TABELA E VLERËSIMIT TË MODULIT

	Zërat	Dobët	Mjaft.	Mirë	Sh. mirë
1	Rezultatet e pritshme	0	2	4	6
2	Përshkrimi i përmbajtjes	0	3	6	9
3	Metodat gjatë trajnimit	0	3	6	9
4	Mjetet mësimore	0	2	4	6
5	Detyrat për pjesëmarrësit	0	2	4	6
6	Literatura e rekomanduar	0	2	4	6
7	Testet	0	3	6	9
	SHUMA				

Emri mbiemri i anëtarit të grupit të vlerësimit _____
Firma _____
Data _____

.....
PLOTËSIMI I TABELËS SË VLERËSIMIT TË MODULIT

1. Njëri sekretar u dikton anëtarëve të një grupi vlerësimi temën e modulit dhe përfituesit. Përfituesit përshkruhen sipas shtojcës 4.
2. Secili anëtar i grupit të vlerësimit e plotëson më vete tabelën, pa u konsultuar me anëtarët e tjerë të këtij grupi.
3. Anëtar i një grupi shqyrton më parë përmbajtjen e të gjitha moduleve me temë të njëjtë që janë paraqitur për vlerësim nga agjenci të ndryshme.

.....
UDHËZIMI PËR PLOTËSIMIN E TABELËS NGA VLERËSUESI

Çdo vlerësues plotëson tabelën duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme:

1. Për një zë të caktuar, vlerësuesi rrumbullakos numrin që tregon vlerësimin e tij për atë zë. P.sh. kur një vlerësues, zërin “Mjetet mësimore” e vlerëson “mirë”, atëherë në tabelën e mësipërme, në rreshtin e zërit “Mjete mësimore”, do rrumbullakosë numrin 4.
2. Vlerësuesi mbledh numrat e shënuar me këtë mënyrë dhe shumën e tyre e vendos të rreshti “Shuma”, të kutiza në fund.

.....



REZULTATET E PRITSHME

Aplikimi përshkruan se çfarë duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të bëjnë të trajnuarit në përfundim të modulit.

Çdo rezultat duhet të jetë i matshëm.

Një rezultat paraqitet me një frazë.

Vlerësuesi duhet të shqyrtojë:

- A është shkruar **qartë** çdo rezultat i pritshëm?
- A është i **matshëm** çdo rezultat i pritshëm?

Më pas, vlerësuesi rumbullakos numrin që tregon “Dobët” ose “Mjaftueshëm” ose “Mirë” ose “Shumë mirë”.

PËRSHKRIMI I PËRMBAJTJES

Përmbajtja e modulit përshkruhet përmbledhtas duke përshirë konceptet kryesore që do të trajtohen gjatë zhvillimit të modulit pa metodologjinë.

Këtu aplikuesi duhet t'i përgjigjet pyetjes “Çfarë trajneri do të zhvillojë në modul?”

Përshkrimi duhet të të jetë 1/3 deri në 1/2 e një faqe A4, e shkruar në kompjuter me Times New Roman.

Vlerësuesi duhet të shqyrtojë:

- A është përshkruar **qartë** përmbajtja e modulit, d.m.th. ju që e lexoni, a kuptoni mjaft mirë se **çfarë** do të zhvillojë trajneri në modul?
- A përshkruhet vetëm përmbajtja, apo përzihet me metodologjinë e zhvillimit të saj?
- A është respektuar vendi që duhet të zërë përshkrimi i përmbajtjes? (1/3 deri në 1/2 e një faqe A4, e shkruar në kompjuter me Times New Roman)

Metodologjia

Te metodologjia përshkruhet përmbledhtas si trajneri do ta zhvillojë përmbajtjen dhe si pjesëmarrësit në trajnim do të arrijnë rezultatet e pritshme.

Metodologjia zërthehet në:

- Metodot gjatë trajnimit.
- Mjetet mësimore.
- Detyra për të trajnuarit.

Metodologjia të jetë 3/4 deri në 1 (një) faqe A4 të shkruar në kompjuter me Times New Roman.

Vlerësuesi duhet të vërejë a e ka respektuar aplikuesi këtë hapësirë që duhet të zërë metodologjia?

METODAT GJATË TRAJNIMIT

Aplikanti përshkruan cilat metoda do përdorë gjatë shtjellimit të etapave të modulit.

Të tilla metoda mund të jenë: Leksioni, demonstrimi, debati, diskutimi, eksperimentimi, puna e pavarur individuale, puna në grupe të vogla, puna me të gjithë pjesëmarrësit, puna me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, loja me role, vizita studimore, biseda me të ftuar etj.

Vlerësuesi duhet të vërejë:

- A përmenden vetëm emrat e metodave apo, për çdo metodë jepen shembuj nga shtjellimi i modulit?
- Mos ka një tepri metodash sa që nuk mund të zbatohen brenda kohës që trajneri ka në dispozicion?
- A është e përshtatshme metoda e përzgjedhur për një etapë të shtjellimit të modulit?
- A përdoret sidomos teknologjia e informacionit dhe komunikimit nga trajneri? Po nga pjesëmarrësit në trajnim?
- Me metodat e përzgjedhura, a lehtësohet arritja e rezultateve të pritshme?

MJETET MËSIMORE

Mjetet mësimore ndihmëse mund të ndahen në:

- Vizuale (fotografi, piktura, diafilma, diapozitivë, flipçart, grafikë, diagrama etj.)
- Auditive (magnetofoni, kasetofoni, radioja etj.)
- Audovizuale (filmi, televizioni, videoja etj.)

Sipas përmbajtjes së modulit, nuk është e nevojshme të përdoren të gjitha mjetet e sipërpërmendura ndihmëse.

Vlerësuesi duhet të vërejë:

- a) A përdor trajneri mjetet e përshtatshme, me të cilat përmirësohet arritja e rezultateve të pritshme?
- b) Mos thjesht përmenden mjetet dhe nuk tregohet konkretisht kur dhe nga kush do të përdoren ato?

DETYRA PËR PJESËMARRËSIT

Detyra për pjesëmarrësit, për t'i kryer gjatë ose/dhe pas modulit, janë punë individuale ose në grup për përgatitje të detyrave tematike, rasteve studimore, projekteve, eseve etj.

Këto detyra zënë pjesën më të madhe të punës së të trajnuarit.

Vlerësuesi duhet të vërejë:

- a) A janë detyrat e ngarkuara të mjaftueshme për të trajnuarin?
- b) A mos janë të mbingarkuara detyrat?
- c) A ndihmojnë detyrat në arritjen më të mirë të rezultateve të pritshme?

LITERATURA E REKOMANDUAR PËR PJESËMARRËSIT

Literatura e rekomanduar për pjesëmarrësit përmban libra dhe shkrime për t'u shfrytëzuar gjatë dhe pas modulit.

Literatura përmban jo vetëm titujt e librave ose të shkrimeve por, edhe ekstrakte të tyre dhe numrin e faqeve dhe cilat faqe duhet të studiojë i trajnuari.

Vlerësuesi duhet të vërejë:

- a) A përmban literatura edhe ekstrakte të librave ose të shkrimeve, si dhe numrin e faqeve dhe cilat faqe duhet të studiojë i trajnuari?
- b) A është e përshtatshme literatura e rekomanduar për përvetësimin e thellë të modulit?
- c) A mund të gjendet lehtë nga të trajnuarit literatura e rekomanduar?
- d) A mos është tepër e vështirë për të trajnuarit literatura e rekomanduar?

TESTET

Dy teste për provimin e modulit bashkë me përgjigjet e tyre.

Një test parashikohet të zhvillohet nga i trajnuari përreth 60-90 minuta dhe synon të verifikojë përmbushjen e rezultateve të pritshme. Në çdo test shënohet dhe kohëzgjatja e tij.

Në rastet kur vlerësimi nuk bëhet me test me shkrim (si rasti i testeve në kompjuter) të paraqitet mënyra e vlerësimit të rezultateve të pritshme.

Vlerësuesi duhet të vërejë:

- a) A mos janë testet tepër të lehta?
- b) A mos janë testet tepër të vështira?
- c) A mundet të trajnuarit ta zhvillojnë testin brenda kohëzgjatjes së parashikuar?

Sekretari gjen totalin e shumave të tre vlerësuesve për një modul të një agjencie trajnuese dhe i dorëzon të KAT-i



SHTOJCA 6
TABELA E VLERËSIMIT

Agjencia e shërbimit trajnues _____

Tema e modulit _____

Tema e seancës _____

TABELA

Përputhja me aplikimin	Po
A zhvillohet takimi sipas orarit së paracaktuar?	
A ka trajneri dokumentin e tij të identifikimit?	
A mban trajneri listën emërore të pjesëmarrësve në trajnime?	
A shënon në listë mungesat?	
A përdor trajneri metodat e planifikuara?	
A përdor trajneri mjetet mësimore të planifikuara?	
A jep trajneri detyra për të trajnuarit?	
A rekomandon trajneri literaturë për të trajnuarit?	
Shuma e pikëve	
Përqindja e pikëve	

Komente

Komentet përmbledhin sugjerimet për përmirësime.

Vëzhguesi

Emri, mbiemri _____

Firma _____

Emri, mbiemri _____

Firma _____

Data _____

.....

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E TABELAVE TË MONITORIMIT

Vëzhguesi e plotëson tabelën duke krahasuar të dhënat për modulin që gjendet të Katalogu, me zhvillimin konkret të modulit.

Vëzhguesi vendos numrin “1” aty ky konstaton përputhje.

P.sh.

Përputhja me aplikimin	Po
A zhvillohet takimi sipas orës së paracaktuar?	
A ka trajneri dokumentin e tij të identifikimit?	1
A mban trajneri listën emërore të pjesëmarrësve në trajnime?	
A shënon në listë mungesat?	
A përdor trajneri metodat mbizotëruese të planifikuara?	1
A përdor trajneri mjetet mësimore të planifikuara?	1
A jep trajneri detyra për të trajnuarit?	1
A rekomandon trajneri literaturë për të trajnuarit?	1
Shuma e pikëve	5

VENDIM
Nr. 35, datë 17.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 14.5.2013 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë dokumentesh çështjen me nr.11 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Anna Nordstrom, përfaqësuar me prokurë nga avokat Isuf Shehu.

SUBJEKT I INTERESUAR: Ferik Velija, përfaqësuar me prokurë nga avokat Spiro Kaso.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “f”, dhe 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja, Anna Hava Nordstrom, në datën 19.2.2013 ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

2. Nga përmbajtja e kërkesës rezulton se në datën 19.1.2011 kërkesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: “Njohjen si trashëgimtare ligjore të radhës së parë të trashëgimlënësit V. Velija, dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore”.

3. Nga momenti i paraqitjes së kërkesëpadisë, deri në kohën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ende nuk ka dalë me një vendim themeli për pranimin ose rrëzimin e saj.

4. Përfaqësuesi i kërkeses, para se t'i drejtohej kësaj Gjykate, ka paraqitur ankim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Ankimi i është drejtuar gjithashtu Ministrisë të Drejtësisë, Avokatit të Popullit dhe Ambasadës Suedeze. Përfaqësuesi i kërkeses ka paraqitur dhe kallëzim penal, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj gjyqtarëve të çështjes. Me vendimin e datës 2.5.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

5. Kërkuesja pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kujdesur që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt duke siguruar progresin e gjykimit me shpejtësi të mjaftueshme. Kërkuesja i mbështet pretendimet e saj në kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës europiane për të Drejtat e Njeriut, të reflektuara më pas në praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Sipas këtyre kriterëve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të



veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkesin kjo tejkzgatje e afateve të gjykimit.

6. *Sipas kërkuesses*, çështja e iniciuar prej saj nuk është një çështje komplekse, pasi faktet dhe natyra e çështjes janë përcaktuar që në fillim të gjykimit, nëpërmjet parashtrimit të bërë dhe provave të paraqitura. Rrethanat e çështjes janë krejtësisht të qarta dhe nuk i japin rastit natyrë komplekse. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve publike, kërkuessa pretendon se zgjatja në kohë e kësaj çështjeje ka ardhur si rezultat i shtyrjes së seancave, pa shkaqe ligjore, nga ana e të paditurit dhe nga ana e gjykatës. Lidhur me sjelljen e saj, referuar kronologjisë së seancave, kërkuessa nuk ka shkaktuar vonesa të pajustificuara për zhvillimin e gjykimit. Përkundrazi, prania e saj e vazhdueshme në të gjitha seancat tregon qartazi përpjekjet e saj për të shpejtuar procesin gjyqësor.

7. *Subjekti i interesuar, Ferik Velija*, kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe paraqiti prapësime me shkrim për çështjen objekt gjykimi, në mënyrë të përmbledhur si vijon:

7.1 Kërkesa për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, është e pabazuar. Shkaqet e shtyrjeve të seancave kanë qenë për shkak të sjelljes së përfaqësuesit të kërkuesses dhe të gjykatës.

7.2 Kërkesat e palës së paditur/subjekti i interesuar në proces, kanë qenë kërkesa të mbështetura në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

7.3 Çështja është e një natyre komplekse sepse kemi të bëjmë me dy palë që janë shtetas të huaj dhe me veprime që janë kryer në dy shtete të huaja.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

8. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se, në bazë të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, me pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Gjykata ka pranuar se kërkesat e individëve, për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

A. Lidhur me pretendimin për shkëlqen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm

9. Kërkuessa ka pretenduar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur standardin e përcaktuar në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës.

10. Gjykata rithekson se lidhur me tejkzgatjen e procesit gjyqësor ajo mbështetet në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, të reflektuara më pas dhe në praktikën e saj. Sipas këtyre kriterëve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesit, sjelljen e autoriteteve si dhe rrezikun që sjell për kërkesin kjo tejkzgatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, rezultoi gjatë gjykimit, se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka filluar shqyrtimin e çështjes më datë 21.03.2011 dhe deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, pas më shumë se dy vjetësh, ende nuk ka një vendim themeli në lidhje me pretendimin e kërkuesses.

12. *Për sa i përket kompleksitetit*, Gjykata Kushtetuese konstaton se gjykimi i iniciuar prej kërkuesses, i cili konkretisht ka për objekt njohjen e saj si trashëgimtare ligjore të radhës së parë dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore, është i natyrës civile. Ky gjykim rregullohet prej dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, mbi gjykimet civile, dhe dispozitat e Kodit Civil, mbi padinë e kërkit të pasurisë trashëgimore (neni 349 e vijues).

13. Gjykata konstaton se, duke pasur parasysh natyrën e tij, gjykimi nuk paraqitet me natyrë komplekse, edhe pse problemet juridike, lidhur me juridiksionin dhe kompetencën, të pretenduara nga subjekti i interesuar, kanë kushtëzuar disa seanca. Megjithatë, ky fakt nuk justifikon zgjatjen për më shumë se dy vjet të procesit.

14. *Për sa i përket sjelljes së kërkueses*, referuar kronologjisë së seancave, kërkuësja nuk ka shkaktuar vonesa të pajustificuara për zhvillimin gjykimit. Përkundrazi, prania e saj e vazhdueshme, në të gjitha seancat e zhvilluara, tregon qartazi përpjekjet për të shpejtuar procesin gjyqësor. Nga materialet e dosjes rezulton se seancat e datave 1.6.2011, 12.2.2012, 23.4.2013, janë shtyrë për shkaqe që i ngarkoheshin kërkueses. Në vlerësim të Gjykatës, këto shkaqe lidhen me përmbushjen dhe ushtrimin e të drejtave të saj procedurale, të parashikuara nga KPC-ja, si parashtrimi i provave mbi të cilat mbështetej kërkimi i ngritur, apo edhe me pamundësinë objektive për të ndjekur seancën gjyqësore, për shkak se mbrojtësit e saj, në të njëjtën ditë dhe orë, ndodheshin në gjykime të tjera. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese përsërit se, për sa i përket sjelljes së kërkueses, përdorimi nga ana e saj i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër saj (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. *Për sa i përket sjelljes së autoriteteve publike*, nga materialet e ndodhura në dosje rezulton se nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë, deri në momentin e shqyrtimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, janë zhvilluar 21 seanca, *medio tempore*; në datën 6.5.2013 është zhvilluar seanca e 21-të. Hapësira kohore e seancave nga njëra-tjetra është relativisht e gjatë, mesatarisht 5-6 javë.

16. Duke iu referuar shkaqeve të shtyrjes së seancave, Gjykata konstaton se një pjesë e tyre i referohen kërkesave të përsëritura të palës së paditur për përjashtim të gjyqtarëve, mosparaqitjes së saj në gjykim për arsye shëndetësore, mosformimit të trupit gjykues etj.

17. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 6 i KEDNJ-së, vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor, në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen artikullimin e saj edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilave: *“gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor.....”*¹ dhe *“gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj”*².

18. Gjykata ka theksuar se për sa i përket sjelljes së autoriteteve, edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve³, kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata, referuar sa më sipër, vlerëson se gjykimi i kësaj çështjeje është tejzgatur për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga veprimet e të paditurit, i cili gjithashtu ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor.

20. Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se, bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim, kërkueses Anna Nordstrom i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹ Neni 4 i Kodit të Procedurës Civile.

² Neni 171, shkronja “a”, i Kodit të Procedurës Civile.

³ Neni 2 i Kodit të Procedurës Civile.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese Anna Nordstrom, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

2. Shumica ka vlerësuar se kërkesat e individëve, për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, mund të merren në shqyrtim, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (paragrafi 8). Në vijim ajo, pasi ka vlerësuar kriteret që lidhen me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkueses dhe të autoriteteve publike, ka arritur në përfundimin se gjykimi i kësaj çështjeje është tejzgatur për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga veprimet e të paditurit, i cili gjithashtu ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor (paragrafët 11-19). Në përfundim, shumica ka vlerësuar se, bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim, kërkueses Anna Nordstrom i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

3. Neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individit mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave për shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve (*shih vendimet nr. 10, datë 2.4.2003; nr. 9, datë 9.5.2005; nr. 10, datë 9.5.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur nga kërkuesi, që do të thotë se individit, përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet

juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 15, datë 18.4.2007; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 36, datë 10.11.2010; nr. 17, datë 16.5.2011*). Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë, bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

5. Kërkuesi duhet të provojë para Gjykatës, në aspektin e shterimit të mjeteve, se nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara, apo edhe se shqyrtimi gjyqësor nuk mund t'i ndreqë këto shkelje. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë, sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

6. Në kuptim të sa më sipër, ne, gjyqtarët në pakicë, mbajmë qëndrimin se kërkuesja nuk duhet të ishte legjitimuar për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur çështja civile e iniciuar prej saj është ende në shqyrtim në sistemin gjyqësor dhe nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata. Bazuar në këtë qëndrim të Gjykatës, i njëjti individ mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim për zvarritje të procesit gjyqësor, në çdo shkallë të tij (edhe gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë) dhe më pas, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor.

7. Qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Në rastin konkret shumica nuk ka verifikuar se cilat janë garancitë procedurale me të cilat janë të pajisura palët gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete dhe nëse kërkuesja i ka shteruar mjete të tilla. Në ndryshim nga shumica, ne vlerësojmë se individët gëzojnë të gjitha garancitë procedurale nga sistemi ligjor, për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Pretendimet që kërkuesja ka ngritur para Gjykatës nuk janë të tilla që t'i shmangen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por mund të parashtrohet më tej në gjykatat më të larta si shkak për apel apo për rekurs. Po ashtu, rendi ligjor ka parashikuar për palët në proces edhe mjete të tjera ligjore që u japin mundësinë atyre që në raste të tilla të kërkojnë qoftë përjashtimin e gjyqtarit, në rast se ai është shkak për vonesat në gjykim, qoftë t'i drejtohen KLD-së me ankesë për të. Këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete.

8. Për sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se kërkuesja Anna Nordstrom nuk ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në respektim të nenit 131/f të Kushtetutës.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj



VENDIM
Nr. 36, datë 25.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 13.9.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr. 21/3 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Bibika Kokalari, përfaqësuar nga avokat Ermir Dobjani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Pëllumb Saliaj, Harilla Kushi, Mersin Balilaj, të përfaqësuar nga avokat Gëzim Hajdëraj;

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 90, datë 10.4.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr. 00-2011-1543, datë 13.10.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42 dhe 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkueses, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja Bibika Kokalari është trashëgimtare ligjore e trashëgimlënësve Platon dhe Pranvera Kokalari. Trashëgimlënësit i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Bashkinë Patos, duke kërkuar kthimin e pronave dhe të një sipërfaqe toke prej 33 ha, të ndodhura në fshatin Visokë të rrethit Fier.

2. Sipërfaqja e tokës është bërë objekt i ndarjes mes specialistëve të ndërmarrjes bujqësore (Bashkia Patos) dhe banorëve të fshatit Visokë, pas miratimit të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe akteve normative për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore.

3. Subjektet e interesuara, Pëllumb Saliaj, Harilla Kushi dhe Mersin Balilaj, me cilësinë e specialistëve të bujqësisë, me kontratën e qirasë të datës 25.3.1993, kanë marrë secili prej tyre në përdorim nga ndërmarrja bujqësore, një sipërfaqe toke prej 18 ha.

4. Gjithashtu, me kontratën e shitjes të datës 31.3.1995, kanë blerë nga Agjencia e Ristrukturimit dhe Privatizimit pemët frutore të ndodhura në këtë sipërfaqe. Bazuar në rregullimet ligjore përkatëse⁴, pas plotësimit me sipërfaqe toke të specialistëve, pjesa tjetër i është lënë në dispozicion

⁴ Udhëzimi nr. 1, datë 7.8.1995 i Ministrisë të Bujqësisë “Për dhënie të tokës në përdorim specialistëve të bujqësisë”, dalë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore” dhe VKM-së nr. 452, datë 17.10.1992 “Për caktimin e kufirit maksimal të tokës që do të jepet në përdorim të specialistëve”.

seksionit të kadastrës në bashkinë Patos, për t'u trajtuar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

5. Komisioni i Ndarjes së Tokës në Bashkinë Patos, me vendimin nr. 7, datë 8.5.1998, ka vendosur ndarjen e sipërfaqes së tokës. Me aktet nr. 32054 dhe nr. 32055 i ka kaluar në pronësi sipërfaqen e tokës prej 18 000 m² Platon Kokalarit dhe sipërfaqen prej 16 000 m² Pranvera Kokalarit, duke i pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

6. Subjektet e interesuara kanë paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt shfuqizimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, në emër të pronarëve Kokalari. Ndërsa trashëgimlënësit Platon dhe Pranvera Kokalari kanë paraqitur kundërpadi, duke kërkuar kthimin dhe dorëzimin e pronës si dhe pavlefshmërinë e kontratës së shitjes të datës 31.3.1995.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 159, datë 7.2.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj e në prova dhe pranimin e kundërpadisë.

8. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 383, datë 3.7.2001, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 159, datë 7.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 583, datë 18.3.2003, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 383, datë 3.7.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim asaj gjykate.

10. Me vendimin nr. 6, datë 14.1.2004, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 159, datë 7.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për pranimin e kundërpadisë, prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes për sa i përket padisë.

11. Mbi rekursin e subjekteve të interesuara, me vendimin nr. 1744, datë 1.10.2004, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit.

12. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni i Ndarjes së Tokës në Qarkun Fier, me vendimin nr. 41, datë 1.3.2005, ka anuluar aktin e marrjes së tokës në pronësi në emër të pronarëve Kokalari, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Ndërsa me vendimin nr. 553, datë 29.6.2005, Komisioni i Ndarjes së Tokës në Bashkinë Patos, u ka dhënë në pronësi sipërfaqen e tokës prej 18 ha subjekteve të interesuara, vendim i cili është miratuar nga Komisioni i Tokës, i Qarkut Fier, me vendimin nr. 78, datë 7.9.2005.

13. Me vendimet e mësipërme, subjektet e interesuara i janë drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Fier, për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi. Zyra ka refuzuar regjistrimin, me arsyetimin se parcelat janë të regjistruara në favor të pronarëve Kokalari. Në këto kushte, subjektet e interesuara i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke kërkuar detyrimin e ZRPP-së Fier, të bëjë regjistrimin e akteve të pronësisë si dhe çregjistrimin e pronësisë në emër të Platon dhe Pranvera Kokalarit.

14. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 904, datë 7.6.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke u shprehur se Komisioni i Ndarjes së Tokës, i Qarkut Fier, nuk ka pasur kompetencë të shfuqizojë aktin e marrjes së tokës në pronësi në emër të Platon dhe Pranvera Kokalarit. Gjykata në arsyetimin e vendimit është shprehur se vendimi i formës së prerë nr. 159, datë 7.2.2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka rregulluar në mënyrë përfundimtare marrëdhëniet e pronësisë midis paditësve dhe personave të tretë.

15. Me vendimin nr. 90, datë 10.4.2009, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 904, datë 7.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke pranuar padinë e paraqitur nga subjektet e interesuara për çregjistrimin e pronës në emër të trashëgimtares Kokalari, si dhe detyrimin e ZRPP-së, Fier, të bëjë regjistrimin, në favor të subjekteve të interesuara. Gjykata e Apelit Vlorë në arsyetimin e vendimit ka vlerësuar se vendimi nr. 159, datë 7.2.2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk përbën gjë të gjykuar dhe nuk ka fuqi detyruese. Vendimi i Komisionit të Ndarjes së Tokës të Qarkut Fier, është vlerësuar i drejtë dhe brenda kompetencave ligjore për shfuqizimin e akteve të komisioneve më të ulëta kur i gjen në kundërshtim me ligjin, të drejtë që komisioni i ndarjes së tokës në qark e ka ushtruar brenda kompetencave të tij.



16. Mbi rekursin e kërkuases, me vendimin nr. 00-2011-1543, datë 13.10.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

Pretendimet para Gjykatës Kushtetuese

17. **Kërkuesja Bibika Kokalari**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 90, datë 10.4.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 1543, datë 13.10.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), duke parashtruar si vijon:

17.1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk ka arsyetuar vendimin e mospranimit të rekursit dhe, si pasojë, nuk ka respektuar pritshmërinë e ligjshme të kërkuases.

17.2. Është cenuar parimi i sigurisë juridike për shkak të zhvlerësimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 159, datë 7.2.2001, si dhe për shkak të zbatimit të procedurave të iniciuara për ndryshimin e një vendimi përfundimtar dhe zgjidhjen ndryshe të çështjes.

17.3. Nuk ka asnjë arsye procedurale dhe materiale që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të mënjanonin parimin e sigurisë juridike (gjë e gjykuar).

18. **Subjektet e interesuara** Pëllumb Saliaj, Mersin Balilaj dhe Harilla Kushi kanë paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

18.1. Kërkuesja nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, pasi kjo e fundit merr në shqyrtim vetëm shkeljet kushtetuese. Pretendimet e ngritura nga kërkuësja lidhen vetëm me zbatimin e ligjit dhe jo me shkelje kushtetuese.

18.2. Vendimet gjyqësore që kërkohen të goditen nuk kanë cenuar parimin e sigurisë juridike. Pretendimet lidhen vetëm me zbatimin e gabuar të ligjeve nga gjykatat më të ulëta.

18.3. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka dhënë përgjigje rekursit të kërkuases, duke vlerësuar se nuk plotëson një prej shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

19. **Subjekti i interesuar** Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, nuk paraqiti parashtrime lidhur me kërkesën objekt shqyrtimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

20. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), paraprakisht, thekson se i vlerëson pretendimet e kërkuases në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të Gjykatës së Lartë për respektimin e këtyre standardeve.

A. Pretendimi i cenimit të parimit të arsytimit të vendimit

A.1. Lidhur me pretendimin e mosarsytimit të shkaqeve të mospranimit të rekursit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)

21. Kërkuesja pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk ka arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit e për pasojë, ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit.

22. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1 të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

23. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Neni 310, pika 1 i Kodit të Procedurës Civile (KPC) parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve.

26. Ndërsa, për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475, pika “ç”) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese qëndron në vlerësimin të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

27. Nga parashikimet e normave të mësipërme procedurale, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, si dhe disponimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë. Janë parashtruar shkaqet në bazë të të cilave kërkuesja pretendon prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

29. Pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit si dhe të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor. Konkretisht, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka pasur parasysh përcaktimet e neneve 451, shkronja “a” (gjë e gjykuar), 494, shkronja “d” (rastet e rishikimit) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 296 të Kodit Civil (padija e rivendikimit), si dhe problemet që zgjidhen gjatë gjykimit të saj.

30. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) në përfundim shprehet se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij. Në çështjen në shqyrtim, pavarësisht se në vendim janë paraqitur shkaqet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, Kolegji nuk ka argumentuar përfundimin e shprehur në dispozitiv për mospranimin e rekursit.

31. Bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

32. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



33. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nisur nga natyra e pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuesja, mungesa e arsytimit të argumenteve në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një mangësi në përmbajtjen dhe në arsyetimin e vendimit të gjykatës.

34. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit, është i bazuar.

A.2. Lidhur me qëndrimin e Gjykatës së Lartë për cenimin e parimit të sigurisë juridike

35. Kërkuesja ka pretenduar se për shkak të fillimit dhe mbarimit të një procedure administrative e më pas gjyqësore për një mosmarrëveshje civile, në një kohë kur kjo mosmarrëveshje ishte zgjidhur përfundimisht me vendimin nr. 159, datë 7.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, është cenuar parimi i sigurisë juridike duke vendosur për çështje të njëjta zgjidhje të ndryshme.

36. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se, në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike.

37. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se “...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim” (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*). GJEDNJ-ja, në disa çështje kundër Shqipërisë (*shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr. 1), datë 3.2.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.7.2012*), ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, veçanërisht për sa i përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie, dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta.

39. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese, parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e të drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në çështjen konkrete, kërkuesja pretendon se vendimet objekt shqyrtimi dhe vendimi nr. 159, datë 7.2.2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kanë të njëjtat palë, të njëjtin objekt gjykimi, i cili lidhet me të drejtat pronësore mbi të njëjtën sipërfaqe toke. Gjykatat më të ulëta me vendimet e tyre kanë arsyetuar në mënyrë të ndryshme për vlerën juridike të vendimit nr. 159, datë 7.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si një vendim i formës së prerë që e ka rregulluar më parë marrëdhënien juridike midis kërkueses dhe subjekteve të interesuara.

41. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta

kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, paraqitur nga kërkesja në rekurs.

43. Në përfundim, Gjykata çmon se vendimi i mospranimit të rekursit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka mbajtur qëndrim për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe nuk ka arsyetuar pretendimet e tjera të ngritura në rekurs. Si rrjedhim, pretendimi i kërkeses Bibika Kokalari është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash:

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës⁵.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-1543, datë 13.10.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Admir Thanza, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete vlerësojmë të shprehemi me mendim pakice, pasi çmujmë se kërkesa e kërkeses duhet të pranohej tërësisht, duke shfuqizuar, për rrjedhojë, edhe vendimin nr. 90, datë 10.4.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

2. Kërkesja, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka pretenduar, midis të tjerash, cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i mosrespektimit, nga gjykatat e zakonshme, në procesin gjyqësor objekt kundërshtimi, të efekteve detyruese të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 159, datë 7.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili, me vendimin nr. 6, datë 14.1.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, është lënë në fuqi për sa i përket pranimit të kundërpadisë me objekt “*Detyrimin e paditësve të na kthejnë dhe dorëzojnë tokën në pronësinë tonë si dhe lajthitë. Pavlefshmërinë e veprimit juridik të shitjes së lajthive në bazë të nenit 92 dhe 296 e vijues të Kodit Civil*”. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 1744, datë 1.10.2004.

3. Në vështrim të jurisprudencës kushtetuese, siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të

⁵ Gjyqtarët Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, votuan dhe për shfuqizimin e vendimit nr. 90, datë 10.4.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjyqtarët Sokol Berberi dhe Admir Thanza votuan për rrëzimin e kërkesës.



cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr.24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Prandaj, vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuesit, ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Ndërsa, në kontekstin e një çështjeje në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe në standardin e vendosur nga Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në vlerësimin kushtetues të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar, kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e të drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në lidhje me pretendimin e cenimit të sigurisë juridike shumica, pasi sjell në vëmendje kuptimin që jurisprudenca kushtetuese i ka dhënë parimit të sigurisë juridike në raport me gjënë e gjykuar dhe konstaton pretendimet e kërkueses se “*vendimet objekt shqyrtimi dhe vendimi nr. 159, datë 7.2.2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kanë të njëjtat palë, të njëjtin objekt gjykimi, i cili lidhet me të drejtat pronësore mbi të njëjtën sipërfaqe toke; Gjykatat më të ulëta me vendimet e tyre kanë arsyetuar në mënyrë të ndryshme për vlerën juridike të vendimit nr. 159, datë 7.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si një vendim i formës së prerë që e ka rregulluar më parë marrëdhënien juridike midis kërkueses dhe subjekteve të interesuara*” (*shih prg. 39-40*), ka arritur në përfundimin se “*Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit ashtu dhe në kontrollin e respektimit e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e sigurisë juridike paraqitur nga kërkuesja në rekurs*” (*shih prg. 42*).

7. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, jemi të mendimit se analiza që shumica i ka bërë parimit të sigurisë juridike, në varësi të rrethanave të çështjes, është e pamjaftueshme, madje e cekët. Në vlerësojmë se, nëse shumica, në rastin konkret, do të kishte përcaktuar kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim, konkluzioni, pa asnjë dyshim, do të kishte qenë i ndryshëm, duke shfuqizuar, krahas vendimit të Kolegjit Civil, edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, në respekt të rivendosjes së të drejtave të cenuara të kërkueses.

8. Shumica, në vendim, nuk analizon thelbin e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi në proceset gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Po ashtu, ndonëse shumica në vendim pasqyron vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nuk merr në analizë vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e të drejtës në rastin konkret, ashtu siç janë të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit të formës së prerë, dhe aq më pak i analizon ato në raport me disponimet e vendimeve objekt kundërshtimi.

9. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e formës së prerë nr.159, datë 7.2.2001, arsyeton se: *“të paditurit kundërpaditës Kokalari janë pronarë të sipërfaqes 34000 m², kurse paditësit e posedojnë këtë tokë në mënyrë të paligjshme...”*. Po ashtu, Gjykata e Apelit Vlorë, që ka lënë në fuqi vendimin e formës së prerë, në vendimin nr. 90, datë 10.4.2009, arsyeton se: *“kundërpaditësit Kokalari, në referim të neneve 296 e 192/a, janë pronarë të tokës që disponojnë dhe kanë qenë të tillë, me cilësinë e ish- pronarëve, qysh para çlirimit...”*. Nga përmbajtja e vendimit nr. 904, datë 7.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se: *“Pavarësisht se nga pikëpamja formale objekt i kësaj padie është çregjistrimi i pasurive të paluajtshme nga persona të tretë dhe regjistrimi i saj në favor të paditësve, në thelb, konflikti ndërmjet palëve qëndron në marrëdhënien e tyre të pronësisë mbi të njëjtën pasuri të paluajtshme... duke marrë parasysh edhe karakterin absolut të së drejtës së pronësisë, gjykata me vendimin e saj nr. 159, datë 7.2.2001, ka rregulluar në mënyrë përfundimtare marrëdhëniet e pronësisë së paditësve dhe personave të tretë në lidhje me sipërfaqen e tokës për të cilën kërkohet çregjistrimi ... përderisa ky vendim nuk është cenuar në një nga mënyrat që parashikon ligji procedural”*. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 904, datë 7.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke pranuar padinë, urdhëruar çregjistrimin e pasurisë tokë pemëtore në emër të personave të tretë Kokalari dhe detyrimin e ZRPP-së Fier ta regjistrojë atë në favor të paditësve, arsyeton se: *“...nuk gjendemi përpara gjësë së gjykuar, kur as nga ana formale nuk janë të njëjtat palë e për rrjedhojë vendimi nr. 159, datë 2.7.2001, nuk ka fuqi detyruese për ZRPP-në përderisa nuk ka qenë palë e atij gjykimi. Gjithashtu, nuk është as i njëjti objekt padie dhe shkak ligjor i padisë është gjithashtu i ndryshëm.”*

10. Ne mendojmë se shumica duhet të kishte marrë në analizë arsyetimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, vendim i cili, në vlerësimin tonë, bie haptazi ndesh me standardet kushtetuese mbi gjënë e gjykuar në raport me sigurinë juridike, për arsye se vë në diskutim efektet e vendimit të formës së prerë nr. 157, datë 2.7.2001, që ka pranuar padinë e pronarit ndaj poseduesit jopronar. Një qëndrim i tillë i pakicës bazohet edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila është shprehur se: *“... palët nuk duhen lejuar që nëpërmjet rrugëve të tërthorta të ngrenë padi të reja, paralele, për të goditur vendime të formës së prerë dhe shkelur parimin e sigurisë juridike (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen “Driza kundër Shqipërisë”, prg. 69)*. Një vendim i formës së prerë (me të cilin, në rastin konkret, është mbrojtur pronësia e kërkueses në raport me subjektet e interesuara), në referim të KPC-së, mund të zhvleftësohet vetëm me anë të procesit të rishikimit, çka i hap rrugën gjykimit të çështjes në themel, por në asnjë rast me një proces të natyrës administrative, me objekt çregjistrimin e titullit të pronësisë, siç ka ndodhur në rastin në shqyrtim.

11. Nga sa më sipër, dhe nisur nga qëndrimi i jurisprudencës kushtetuese se përbën cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rasti kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës Civile, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor, vlerësojmë se shkelja e të drejtës së kërkueses për një proces të rregullt ligjor, nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë, nuk është plotësuar ose korrigjuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

12. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, duke iu referuar standardit se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces; po ashtu, në respekt të parimit të subsidiaritetit, të ekonomisë gjyqësore dhe të administrimit sa më efektiv dhe praktik të drejtësisë; bazuar në kufijtë e ndryshëm ligjorë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë me atë të Apelit; si dhe nisur nga natyra e rrethanave të çështjes konkrete, mendojmë se shumica duhej të shfuqizonte edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, si e vetmja mënyrë efektive për rivendosjen e të drejtave të cenuara të kërkueses gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 1.8.2013
Doli nga shtypi më 1.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë